

## AKT THEMELIMI

### I SHOQËRISË " ARTEMISIA " SH.P.K.

Sot, me datë 19.09.2024

**Z. Enriketa Kroi**, shtetas Shqiptar, lindur më 07/10/1976 në Kukës., Shqiperi, mbajtës I Kartes se ID me nr 036431258, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "ARTEMISIA " Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

#### NENI 1

##### EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është " ARTEMISIA "Sh.p.k.

#### NENI 2

##### SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Tirane Tirane TIRANE Rruga Papa Gjon Pali i Dyte, Pallati Nr.11/1 .Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

#### NENI 3

##### KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

#### NENI 4

##### OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Mjek, Klinike Gjinekologjike, Sherbime te analizave mikrobiologjike, kimike ,hormonale, bakterologjike,molekulare dhe gjenetike. Studime ne fushen e Obstetrikogjinekologjike.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 1,000,000 Lek dhe është i ndarë në 1 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Enriketa Kroj**..zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1,000,000 Lek dhe 1,000,000 Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Enriketa Kroj**...e cila zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## **NENI 7**

### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8**

### **DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar **Z. Enriketa Kroj**, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. \_\_\_\_ për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

### **ORTAKËT THEMELUES**

**Z. Enriketa Kroj**

